



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:103962

Datë: 17.07.2024

Numri i dokumentit: 05948283

**C.nr.416/21**

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil**, gjyqtari Petrit Curri me bashkëpunëtorin Profesional Visar Morina, në çështjen juridike të paditësit A.Kme adresë banimi në F.K, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. Liri Krasniqi nga Malisheva, ndaj të paditurës Komuna e Malishevës–Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati publik komunal Mujë Sahitaj, sipas bazës juridike kompensim i shujtave dhe shpenzimeve të udhëtimit, vlera e kontestit jashtë seancës gjyqësore me datë 17.07.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Pa shqyrtim kryesor të çështjes**

- I. APROVOHET** pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.Knga F.K, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Malishevës–Drejtoria e Arsimit, që në emër të kompensimit për shujta ditore dhe shpenzimeve të udhëtimit, t'ia paguaj paditësit **A.K**shumën e përgjithshme prej **2,268.00 euro (Dymijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë euro)**, dhe atë:
- a.** Në emër të shpenzimeve të udhëtimit nga vendbanimi i tij në F.K e deri në SHFMU “Hasan Prishtina” në fshatin T./Malishevë, t'ia paguaj shumën prej 1,064.00 euro, për periudhën nga viti shkollor 2019-2021 ose për gjithsejtë 380 ditë pune, të përlllogaritur nga 2.80 euro për një ditë pune, në 70% të biletës (4 euro bileta për një ditë vajtje-ardhje), pra 2.80 euro X 380 ditë = 1,064.00 euro dhe
- b.** Në emër të shujtës ditore për ditët prezent në punë, t'ia paguaj shumën prej 1,204.00 euro, të përlllogaritur nga data 01.09.2019 deri më datë 23.11.2022 ose për gjithsej 602 ditë pune, t'ia paguaj nga dy euro në ditë, ose shumën prej 1,204.00 euro (602 ditë x 2 euro = 1,204.00 euro), të gjitha këto në afatin prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.
- II. REFUZOHET** si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadiës e kërkuar në emër të shpenzimeve të udhëtimit mbi shumën e aprovuar si në pikën -I- për periudhën për vitet 2017-2018 (për 32 ditë pune), ose për shumën prej 89.60 euro, si e parashkruar.

**III. DETYROHET** e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumën prej 125.00 euro, dhe atë në emër të parashtrimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 21.00 euro.

### **A r s y e t i m**

Paditësi A.Kme adresë banimi në F.K, përmes të autorizuarës së tij Av. Liri Krasniqi nga Malisheva, në këtë gjykatë ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Malishevës–Drejtoria e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim i shujtave dhe shpenzimeve të udhëtimit. Sipas padisë, paditësi është i punësuar si mësimdhënës në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët-SHFMU “Hasan Prishtina” në T., dhe për shpenzime të udhëtimit dhe shujtave ditore, paditësi ka paraqitur kërkesë me shkrim pranë të paditurës, por nuk ka pranuar përgjigje formale lidhur me kërkesën, edhe pse ka kaluar afati ligjor prej 30 ditësh, andaj gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

E autorizuar e paditësit përmes parashtrësës së datës 16.11.2023 ka bërë precizimin e padisë duke i bashkangjitur edhe vërtetimet mbi ditët prezent në punë, ashtu që ka theksuar se paditësi, lidhur me shpenzimet për udhëtim për periudhën nga viti 2017 deri në vitin 2021 i ka 412 ditë pune dhe sipas llogaritjes i takojnë 1,153.60 euro (2.40 euro bileta X 412 ditë pune = 1,153.60), ndërsa lidhur me kompensimin për shujta ditore për periudhën nga data 01.09.2019 e deri në përfundim të Kontratës Kolektive i ka 602 ditë pune dhe duke e llogaritur shujtën ditore me 2 euro për një ditë pune, atëherë ka shtuar se i takojnë 1,204.00, andaj nga gjykata ka kërkuar që të aprovohet në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditësit si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar sipas petitumit të padisë, dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 104 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 21 euro (nuk e ka kërkuar kamatën).

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësit e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

E paditura përmes përgjigjes në padi, ndër të tjera e ka kontestuar padinë e paditësit duke theksuar se kontrata kolektive e arsimit e lidhur mes SBASHK dhe MASHT është shkëputur nga MASHT dhe kjo kontratë kolektive tani nuk është në fuqi pasi që palët të cilat e kanë nënshkruar këtë kontratë nuk kanë pasur legjitimitet që ta nënshkruajnë dhe i ka munguar baza ligjore për nënshkrimin e saj, e gjithë kjo bazuar në njoftimin që ka bërë MASHT për SBASHK me datë 21.11.2022. Po ashtu, MAPL ka bërë njoftim për kryetarët e Komunave me datë 22.11.2022 për shkëputjen e kësaj kontrate nga MASHT për mungesë të bazës ligjore dhe në fund ka theksuar se ky borxh është parashkruar.

Meqenëse kjo kontratë tani nuk është në fuqi, pasi është shkëputur nga MASHT dhe ka qenë e lidhur nga kjo ministri, komuna e Malishevës - DKAE lidhur me këtë çështje kontestuese nuk ka legjitimitet të palës aktive në këtë procedurë, por këtë legjitimitet tani e ka MASHT, andaj i ka propozuar Gjykatës që ta refuzon padinë e paditësit si të pabazuar ose kjo çështje kontestuese të zhvillohet ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës–MASHT.

*Provat e administruara dhe vlerësimi i tyre*

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i shqyrtoi këto prova dhe atë: Kontratën e Punës nr. 11/754 të datës 06.09.2018, Vërtetimet mbi marrëdhënien e punës dhe ditët në punë nr.1181/21 të datës 18.03.2021, nr.1416/23 të datës 04.07.2023 dhe nr.1417/23 të datës 04.07.2023, certifikatën e vendbanimit nr. ser. B.të datës 17.03.2021 dhe biletat e udhëtimit-kuponët fiskal të lëshuar nga NTSH “Lumi Reisen”.

Pas vlerësimit të të gjitha provave veç dhe veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është e pjesërisht e bazuar, dhe të njëjtën edhe e aprovoj pjesërisht për nga lartësia.

Në bazë të provave të sipërpërmendura dhe përgjigjes së dhënë në padi nga e paditura, gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në punë dhe detyra të punës si mësimdhënës në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët-SHFMU “Hasan Prishtina” në fshatin T. dhe kjo vërtetohet nga kontrata e punës nr.11/754 të datës 06.09.2018.

Në bazë të vërtetimeve për ditët prezent në punë të lëshuara nga e paditura, nuk është kontestuese se paditësi lidhur me shpenzimet e udhëtimit për periudhën 2017 deri 2021 i ka gjithsejtë 412 ditë pune, kurse lidhur me kompensimin për shujta ditore për periudhën 01.09.2019 deri 23.11.2022 i ka gjithsejtë 602 ditë pune dhe kjo dëshmohet sipas vërtetimeve mbi marrëdhënien e punës dhe ditët në punë nr.1181/21 të datës 18.03.2021, nr.1416/23 të datës 04.07.2023 dhe nr.1417/23 të datës 04.07.2023.

Gjatë analizimit të biletave të udhëtimit-kuponëve fiskal të lëshuara nga N.T.SH. “Lumi Reisen”, është vërtetuar fakti se paditësi ka udhëtuar në relacionin F.K-T./Malishevë dhe anasjelltas, dhe për të shkuar në SHFMU “Hasan Prishtina” në T., prej vendbanimit të tij në F.K, ka shpenzuar nga 4.00 euro për biletë ditore në të dy drejtimet (dy euro në një drejtim), kurse në bazë të certifikatës së vendbanimit nr. ser. B.të datës 17.03.2021 të lëshuar nga zyra e gjendjes civile në F.K, vërtetohet fakti se paditësi vendbanimin e ka në F.K, rruga “H. G.”.

#### Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në bazë të provave të sipërpërmendura dhe përgjigjes së dhënë në padi nga e paditura, gjykata ka vlerësuar se nuk është kontestuese se paditësit i takon e drejta e kompensimit të mjeteve në emër të shujtave ditore dhe shpenzimeve të udhëtimit për periudhën përkatësisht ditët si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjë për cilën e paditura e ka pohuar këtë të drejtë të tij, andaj nga provat e administruara, si dhe konform dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021 të lidhura në mes Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SBASHK, sipas nenit 35 par.7 lidhur me pagesën e shujtave përcaktohet se: *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore, punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*, ndërsa lidhur me kompensimin në emër të shpenzimeve të udhëtimit sipas nenit 35.5 përcaktohet se: *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimin e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen*

*shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut rrugor”, andaj kjo gjykatë vlerëson se paditësit i takon e drejta e kompensimit për shujtë ditore dhe shpenzime të udhëtimit gjatë punës për ditët e pranisë në punë përkatësisht për periudhën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

Kontratën e punës dhe vërtetimet e lartcekura, gjykata i ka pranuar si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1 të LPK-së në të cilin paragraf përcaktohet se: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”,* ngase të njëjtat janë dokumente të lëshuara nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, andaj vërtetimeve për ditët e punës dhe kontratën e punës me të cilat është konstatuar se paditësi është në marrëdhënie pune pranë të paditurës, gjykata ua fali besimin e plotë.

Sipas nenit 8 par. 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve *“Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre”* ndërsa dispozita e nenit 245 par.1 të LMD-së, ka paraparë se: *Kreditori në marrëveshjet e detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë”,* ndërsa në Ligjin e Punës Nr.03/L-212 Gazeta Zyrtare Nr. 90/01 Dhjetor 2010 në dispozitat e nenit 90 par.5 lidhur me Marrëveshjen Kolektive përcaktohet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”,* meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura lidhur me kërkesën për kompensimin në emër të shpenzimeve të udhëtimit, u vendos që të njëjtën ta aprovoj sipas periudhës për vitin 2019 dhe 2022 gjatë së cilës paditësi ka punuar tek e paditura fakt ky që u vërtetua edhe nga vërtetimet e lartcekura, dhe në këtë gjendje të vërtetuar faktike, gjykata e ka detyruar të paditurën, që paditësit t’ia paguaj shumën si në pikën -I- të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësit, por gjykata pretendimet e tilla i ka konsideruar pjesërisht si të bazuara, përkatësisht gjykata vlerëson se kërkesa e paditësit për periudhën 2017 dhe deri 26.05.2018 është e parashkruar, ngase në vështrim të shkresave të lëndës, konstatohet se paditësi padinë e ka parashtruar me datën 26.05.2021, ndërsa kërkesa e padisë për shpenzime të udhëtimit rezulton e kërkuar nga viti 2017, kurse sa i përket kërkesave pas datës 26.05.2018 për gjykatën padia rezulton e afatshme e që për rrjedhojë në rastin konkret nuk ka parashkrim të kërkesës, dhe nga kjo gjendje faktike ndërlidhur me dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sa i përket kërkesave neni 87 lidhur me afatin e parashkrimit përcaktohet se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”,* dhe lidhur me këtë, është refuzuar pjesa tjetër e padisë mbi shumën e aprovuar vetëm për shpenzime të udhëtimit, ose shuma prej 89.60 euro sikurse në pikën -II- të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Lidhur me pretendimet e të autorizuarit të të paditurës lidhur me legjitimitetin e saj në procedurë, gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pabazuara ngase e paditura lidhur me kompensimin në emër të shpenzimeve të udhëtimit obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Kolektive, nënshkruese e së cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se: *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”*, ndërsa me dispozitat e par.1.2 përcaktohet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”*, ndërsa sa i përket pretendimeve për shkëputjen e kontratës kolektive, për gjykatën po ashtu të njëjtat janë të pabazuara, ngase paditësit sipas padisë kërkojnë realizimin e të drejtave gjatë periudhës në të cilën ishte në fuqi Kontrata Kolektive, për çka edhe rrjedhimisht derivojnë të drejtat nga akti juridik i tillë.

Lidhur me vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore si në pikën -III- të dispozitivit, gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 449 dhe nenit 453 par.1 dhe 2 të LPK-së ku parashihet se: *“Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t’i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat”*, si dhe në bazë të rregullores për tarifat e avokatëve, ashtu që vendosi që paditësit t’ia njoh shpenzimet e procedurës duke e detyruar të paditurën që paditësit t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 125.00 euro dhe atë: në emër të parashtrimit të padisë t’ia paguajë shumën prej 104.00 euro (sipas numrit tarifor 6 të rregullores për tarifat e avokatëve në kontestet me vlerë mbi kontestin e vlerës së vogël e deri ne 10.000 €) dhe shumën prej 21.00 euro në emër të taksës gjyqësore.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 152 dhe 398 të LPK-së si dhe nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës lidhur me nenin 35.5 dhe 35.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë.

**Gjykata Themelore në Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë**  
**Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil**  
**C.nr.416/21, datë 17.07.2024**

**G j y q t a r i**  
**Petrit Curri**

**Udhëzim juridik:** Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate.